



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.02.2025

Nr: 193

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN  
NR. 46 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTIA  
DEMOKRATIKE**

Sot më datë 25.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**SUBJEKT:** Zj. Valbona Kola  
Kryetar i Bashkisë Klos

**OBJEKT:** Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, nëpërmjet shpalljes së procedurës të prokurorit Mbikqyrje “Sistemim asfalti rruga Shkallë-Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër”, Bashkia Klos

**BAZA LIGJORE:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

**K O N S T A T O J :**

Partia Demokratike më datë 21.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 45 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

*“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Bashkia Klos ka realizuar procedurat e prokurorit për Mbikqyrjen “Sistemim asfalti rruga Shkallë-Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër” me financim nga buxheti i Bashkisë Klos, para fushatës zgjedhore. Është publikuar njoftimi për*

Data: 25.02.2025

Nr: 193  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 46 ID datë 21.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partia Demokratike”

shpalljen e procedurave të prokurorimit me këto të dhëna:

- Autoriteti/enti kontraktor: *Bashkia Klos*;
- Lloji i procedurës së prokurimit: *E hapur e thjeshtuar*;
- Objekti i kontratës: *Mbikëqyrje “Sistemim asfalti rruga Shkallë-Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër”*;
- Numri i referencës së procedurës/Lotit: *REF-35072-01-07-2025*;
- Fondi limit: *1 202 417,00 Lek pa TVSH*;
- Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: *Data 20-01-2025*”.

Nga sa më sipër çmuj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
  - Zj. Valbona Kola, Kryetar i Bashkisë Klos
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**